



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2020:148704

Datë: 06.10.2023

Numri i dokumentit: 04761670

PPP.nr.2557/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtarin Blerand Rrmoku, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit I.B nga P, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson S.K, avokat në P, kundër debitorit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës - Qendra Klinike Universitare e Kosovës SHSKUK – QKUK, me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbartimore përmbushje e borxhit, vlera 866.98€, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i debitorit, kundër Urdhrit për lejimin e Përmbartimit P.nr.2060/20, të datës 03.06.2020, të lejuar nga Përmbartuesi Privat A.M në P, jashtë seancës gjyqësore, me datë 06.10.2023, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

I. APROVOHET i bazuar prapësimi i përfaqësuesit të autorizuar të debitorit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës - Qendra Klinike Universitare e Kosovës SHSKUK – QKUK, me seli në Prishtinë.

II. ANULOHET Urdhri për lejimin e Përmbartimit P.nr.2060/20, të datës 03.06.2020, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat A.M në P, si dhe REFUZOHET i pabazuar propozimi për përmbartim i parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit I.B.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat A.M në P, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të parashtruar nga i autorizuari i kreditorit I.B, ka lejuar përmbartimin në bazë të Urdhërit Përmbartimor P.nr.2060/20, të datës 03.06.2020, në bazë të dokumentit përmbartimor – vendimit të Inspektoratit të Punës Nr.01-Nr.21-1715-94, i datës 10.02.2020 dhe vendimit nr.303/2020, të datës 19.05.2020, me të cilin Urdhër është detyruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga t’ia paguajë kreditorit borxhin prej 866.98€, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër këtij Urdhëri Përmbartimor, brenda afatit të paraparë ligjor prapësim ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i debitorit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës - Qendra Klinike Universitare e Kosovës SHSKUK – QKUK, me seli në Prishtinë. Në prapësim, ndër tjera theksohet se në Urdhërin për Përmbartim është konstatuar në mënyrë të gabuar gjendja faktike, ndërsa në vendimin mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi nuk është caktuar shuma e të hollave mjeteve monetare të cilat debitori duhet t'ia paguajë kreditorit. Më tutje pretendohet se dokumenti në bazë të të cilit është lejuar përmbartimi nuk mund të paraqitet si dokument ekzekutiv dhe se i njejtë nuk është i përshtatshëm për përmbartim ashtu siç kërkohet me nenin 27 par.1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore dhe në këtë kuptim Urdhëri Përmbartimor është lëshuar në kundërshtim me nenin 71 dhe 73.3 të LPP-së. Po ashtu, pretendohet se propozimi për përmbartim është paraqitur në kundërshtim me nenin 144 të Ligjit për Procedurën Administrative, i cili parasheh që akti administrativ ekzekutohet kur hynë në fuqi dhe bëhet i ekzekutueshëm nga vetë organi administrativ i cili e ka nxjerrë këtë vendim, ndërsa vendimi mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi nuk është bërë ende i ekzekutueshëm sepse sipas këshillës juridike pala e pakënaqur ka pasë të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, të drejtë të cilën debitori e ka shfrytëzuar pranë organit të shkallës së dytë të Inspektoratit të Punës dhe ende nuk ka pranuar përgjigje lidhur me këtë ankesë. Bazuar në këto pretendime, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet Urdhëri për Përmbartim.

Përmes përgjigjes në prapësim, përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit i ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuara pretendimet e debitorit të dhëna në prapësim, duke shtuar se përmbajtja e prapësimit nuk e përmbushë asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71 të LPP-së. Tutje theksohet se pretendimi i debitorit që vendimi i Inspektoratit nuk është titull përmbartimor është i pa bazuar, për faktin se ky vendim paraqet titull përmbartimor konform nenit 22 par.1 nënpar 2 të LPP-së, sepse vendimi i shkallës së parë është bërë i formës së prerë dhe i përmban dy vula: atë të përmbartueshmërisë dhe ekzekutueshmërisë. Lidhur me shumën, përfaqësuesi i kreditorit pretendon që shuma të cilën Inspektorati i Punës me vendimin e saj e ka obliguar debitorin për pagesë është e bazuar në listën e pagave, gjegjësisht duke u bazuar në pagën mujore të kreditorit. Po ashtu, theksohet se debitori në prapësimin e tij nuk ka paraqitur asnjë dëshmi apo provë lidhur me pretendimet e ngritura, siç kërkohet konform dispozitës së nenit 69 par.4 të LPP-së, andaj ka propozuar që prapësimi i të njejtit të refuzohet si i pabazuar dhe të vërtetohet urdhri përmbartimor.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të përfaqësuesit të autorizuar të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i bazuar për arsyet në vijim:

Dispozita nga neni 24 par.3 e LPP-së parasheh që: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbartimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*. Në anën tjetër, neni 27 par.1 i LPP-së përcakton elementet që duhet t'i përmbajë një dokument përmbartimor në mënyrë që të jetë i përshtatshëm për përmbartim. Kjo dispozitë parasheh që *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Referuar mënyrës se si është formuluar, rrjedh se dispozita në fjalë kërkon që elementet e renditura më sipër duhet të përmbushen në mënyrë kumulative dhe mungesa e njërit

prej tyre në dokumentin përbarimor, rrjedhimisht ia heqë cilësinë e dokumentit të përshtatshëm për përbarim.

Në rastin konkret, propozimi për përbarim është paraqitur duke u mbështetur në Vendimin e Inspektoratit të Punës, Nr.01-Nr.21-1715-94, i datës 10.02.2020 dhe vendimit nr.303/2020, të datës 19.05.2020. Në bazë të shqyrtimit të këtij vendimi, Gjykata gjen se në dispozitiv të të njejtit është aprovuar si e bazuar ankesa dhe është obliguar debitorja që të bëjë pagesën e shpërblimit jubilar për 1497 punonjës të QKUK-së, në mesin e të cilëve edhe kreditorit I.B. Megjithatë, këtij Vendimi i mungon shuma e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitores, si një nga elementet që duhet t'i përmbajë dokumenti përbarimor për të qenë i përshtatshëm për përbarim.

Në prezencën e rrethanave të tilla, Gjykata vlerëson se vendimi mbi bazën e të cilit është lejuar përbarimi në këtë çështje juridike nuk i përmbushë kriteret e kërkuara ligjore për të qenë i përshtatshëm për përbarim në kuptim të dispozitës nga neni 27 par.1 lidhur me nenin 24 të LPP-së.

Gjykata me rastin e vendosjes mori parasysh faktin se në shkresat e lëndës, përveç vendimit mbi bazën e të cilit është lejuar përbarimi janë të bashkangjitura edhe shkresa tjera si: lista e pagave për kreditorin, mirëpo Gjykata nënvizon faktin se meqë kemi të bëjmë me procedurë rigorozisht formale, me rastin e vendosjes lidhur me ligjshmërinë e lejimit të përbarimit, duhet kufizuar vetëm në vlerësimin e përshtatshmërisë së dokumentit përbarimor, që në rastin konkret është vendimi i Inspektoratit të Punës Nr.01-Nr.21-1715-94, i datës 10.02.2020 dhe vendimit nr.303/2020, të datës 19.05.2020.

Po ashtu, Gjykata mori parasysh faktin se shkresave të lëndës i është bashkangjitur edhe Vendimi i Inspektoratit të Punës Nr.01/21-1178, i datës 18.11.2020 për korigjimin e gabimeve në vendimin nr.01 nr.21-1715/94, të datës 10.02.2020, si dhe lista e punëtorëve në vendimin burimor me të dhënat e numrave personal si dhe vlerat e shumës për pagesë të punonjësve që janë të evidentuar në këtë vendim. Megjithatë, Gjykata nënvizon faktin se në çështjen konkrete, propozimi për përbarim është mbështetur në vendimin Nr.01-Nr.21-1715-94, të datës 10.02.2020, mbi bazën e të cilin vendim edhe është lejuar përbarimi dhe i cili vendim për arsyet e lartëcekura nuk i plotëson kriteret e kërkuara ligjore për tu konsideruar i përshtatshëm për përbarim. Në anën tjetër, fakti se është bërë korigjimi i këtij vendimi përmes një vendimi të ri, nuk ka ndikim dhe relevancë në vlerësimin e përshtatshmërisë së vendimit i cili është objekt shqyrtimi dhe nuk paraqet bazë për vendosje ndryshe. Nisur nga kjo gjendje, pala kreditore nuk ka ndonjë pengesë që të parashtrijë propozim tjetër duke iu referuar dokumentit i cili i plotëson kushtet për të qenë i përshtatshëm për përbarim konform dispozitave në fuqi të LPP-së.

Si përfundim, bazuar në faktin se Urdhëri Përbarimor është lejuar mbi bazën e një dokumenti i cili nuk është i përshtatshëm për përbarim, Gjykata konstatoi se prapësimi i ushtruar nga debitori gjen mbështetje në dispozitën e nenit 71 par.1 pika 1.1 të LPP-së, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e aprovuar si të bazuar prapësimin, duke e anuluar Urdhërin për lejimin e Përbarimit P.nr.2060/20, të datës 03.06.2020, të lëshuar nga Përbaruesi Privat

A.M në P, si dhe duke e refuzuar si të pabazuar propozimin për përmbarim të parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit I.B.

Nga arsyet e lartëcekura, në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm  
PPP.nr.2557/20, datë 06.10.2023

Gj y q t a r i,  
Blerand Rrmoku

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.